



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e III

Mbledhja nr. 9

Prishtinë, më 04. 09. 2008, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P R O C E S V E R B A L
i mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Sabri Hamiti, Nexhat Daci, Xhavit Haliti, Lutfi Haziri, Ramë Buja, Radmilla Vujoviç, Enis Kervan dhe Ramadan Avdiu.

Munguan: Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, dhe Ardian Gjini.

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Minire Hasani, Ahtere Loxha, dhe Manush Krasniqi.

Pjesëmarrës të tjerë: monitorues nga NDI, OSCE, Instituti GAP dhe Zyra e Presidentit.

Mbledhjen e kryesoi Sabri Hamiti - kryetar i Komisionit

Për këtë mbledhje është propozuar ky

Rend dite

1. Diskutim për agjendën e punës,
2. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Diskutim për agjendën e punës

Kryesuesi – I përshëndeti anëtarët në mbledhjen e parë pas pushimeve dhe i njoftoi anëtarët e Komisionit se qëllimi i takimit ishte për t'i precizuar disa çështje lidhur me agjendën e punës. Në radhë të parë të saktësohet orari i mbajtjes së mbledhjeve të Komisionit. Propozoi që mbledhjet të mbahen çdo dy javë, të mërkurën, andaj kërkoi nga anëtarët të përcaktohen për fillimin e mbledhjeve.

Lidhur me këtë e hapi diskutimin.

Kishte propozime nga anëtarët e Komisionit që mbledhjet të fillojnë në orën: 11:00, 13:00 ose në orën 14:00. Pas diskutimeve dhe propozimeve të anëtarëve, Komisioni u pajtua që mbledhjet e Komisionit të Punëve të Jashtme të mbahen çdo dy javë, të mërkurën, në orën 14:00.

Kryesuesi - Si çështje tjetër në kuadër të kësaj pike e ngriti atë të diferencimit të interesave të anëtarëve të Komisionit, që të ketë paraqitje vullnetare të interesave të anëtarëve të Komisionit se për cilat pika të komunikimit janë më të interesuar - kanë përgatitje dhe afinitet për angazhimin në komunikim me të tjerët. Propozoi të formohen 3 grupe:

1. Komunikimi me fqinjët, 2. Me Bashkimin Evropian, 3. Me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Xhavit Haliti – E propozoi edhe „Diasporën”.

Kryesuesi - Sqaroi se nuk do të jenë grupe strikte, por orientim i punëve tona të brendshme, që në bazë të përgatitjeve, dëshirave dhe interesave, të kemi pak më shumë grupe të përqendruara. Kërkoi nga anëtarët, nëse pajtohen, të ketë një profilizim të vogël dhe vetë anëtarët ta shfaqin interesin për këto grupe. Nëse nuk mund të caktohen emrat gjatë kësaj mbledhjeje, atëherë të mendohemi t'i caktojmë në mbledhjen tjetër dhe t'i evidencojmë. Lidhur me këtë e hapi diskutimin.

Nexhat Daci - Nuk ishte i bindur shumë se është e domosdoshme ndarja nëpër grupe, sepse tha të gjithë mund të përcaktohen për njërin grup. P.sh.: ndonjëri nga anëtarët është i përcaktuar për bashkëpunim me Amerikën, kurse në rend dite vihet ndonjë tematikë që mund të japë kontribut shumë të mirë me Evropën, ose me diasporën, andaj nuk do të ndihmonte në këtë drejtim, por nëse shumica pajtohet, nuk ka asgjë kundër.

Kryesuesi - Theksoj se kjo është në nismë dhe kam menduar që më tepër të shfrytëzohen kapacitetet e grupit e jo t'i diferencojmë anëtarët, sepse nuk do të thotë se ka orientim nga Evropa e të mos jetë aktiv për forma të tjera. Kjo ishte vetëm ide e punës dhe ka për qëllim përqendrimin dhe ndarjen e punëve dhe të afiniteteve.

Çështje tjetër, në kuadër të kësaj pike, ishin edhe raportet e këtij komisioni me institucionet që kanë raporte në bazë të programit të vet. Tha se tani gjendemi në një situatë krejt tjetër dhe marrëdhëniet politike ndërkombëtare kanë marrë status tjetër, sepse e kemi krijuar edhe Ministrinë dhe për këtë problem duhet biseduar sa më parë me

kryetarin e Kuvendit, me Kryesinë, me Qeverinë dhe me Ministrinë. Tha se për të funksionuar si duhet ky komision duhet të diskutohet edhe çështja materiale, sepse ky komision nuk kishte mjete të ndara nga buxheti. Në rebalancin e buxhetit që kaloi ishte propozuar që komisionet e Kuvendit të kenë buxhet të vetin për kryerjen e veprimtarive, por kjo nuk u realizua. Ky komision është shumë specifik dhe kushtëzohet nga paratë, andaj kërkoj ide si të zhblllokohet kjo situatë.

Xhavit Haliti - Përkrah idenë e kryetarit të Komisionit për ndarjen e punëve, por tha se për t'i realizuar idetë duhet të kemi buxhet dhe buxheti i Kuvendit të kontrollohet nga vetë Kuvendi, nga njerëzit më të besueshëm, si çdokund tjetër në shoqëritë demokratike, e jo të kontrollohet buxheti nga nëpunësit e ndryshëm.

Shtoi se hapi parë që do duhej ta bënte tani si komision, është të kërkojmë nga Qeveria që Projektligjin për buxhet ta dorëzojë në Kuvend në afatin ligjor që është më 15 shtator. Në procedurën e miratimit të buxhetit të insistojmë që secili komision t'i shqyrtojë buxhetin dhe kërkesat e veta dhe të mos i dërgojë në Komisionin për Buxhet, por drejtpërsëdrejti në seancë. Nëse kjo nuk bëhet kështu, planet e të gjitha komisioneve për t'u angazhuar do të mbeten vetëm dëshirë. Si komision kemi mjaft angazhime edhe jashtë këtij komisioni. Edhe më parë i kemi propozuar 2-3 grupe për krijimin e raporteve, veçanërisht për raportet me Turqinë dhe për këtë duhet të diskutohet në mbledhjen e ardhshme, sepse ka mbetur ide dhe nuk është materializuar në Komision. Duhet ta kërkojmë si komision shtimin e buxhetit të Kuvendit të Kosovës, sepse nevoja është më e madhe sesa është përcaktuar. Buxhetin e Kuvendit do të duhej ta kontrollonte dhe ta menaxhonte vetë Kuvendi dhe ai të japë llogari para ligjit me formula përkatëse për procesin e vendimmarrjes, për mbikëqyrjen për shpenzimet e udhëtimeve e jashtë vendit, sepse përkundër përpjekjeve për ta kanalizuar këtë çështje, gjërat nuk janë vënë në binarë.

Kryesuesi - Koordinimi dhe përfaqësimi i udhëtimeve jashtë është problem që na ka ndjekur që nga mandati i parë. Në bazë të rregulloreve të disa vendeve, me të cilat kemi bashkëpunuar, koordinimi i udhëtimit i përket Komisionit tonë. Kryesia në një mbledhje e ka shqyrtuar këtë problem dhe ideja është që ky koordinim t'i takojë Komisionit tonë, mirëpo ende nuk është vendosur ligjërisht për këtë. Është e nevojshme të vlerësohet nga një komision që të ketë pasqyrë të qartë se çka është e domosdoshme, kush duhet të udhëtojë, e kush jo. Mendoj se pas konsultimeve plotësuese me Kryesinë e Kuvendit dhe me kryetarin e Kuvendit do ta marrim një qëndrim. Çështja e buxhetit të komisioneve në rebalanc nuk ka kaluar, por ne duhet të insistojmë se komisionet duhet të kenë buxhet të vetin. Këtë nuk mund të na e ndalojë askush nëse Kuvendi konsideron se është e domosdoshme dhe kjo mund të bëhet tash, kur propozohet buxheti për vitin e ardhshëm. Kuvendi duhet të ketë projektbuxhet të vetin të fiksuar për vitin e ardhshëm, kurse për sivejet është vonë. Propozoj që kur të bëhet plani i buxhetit të Kuvendit për vitin e ardhshëm, të hyjë propozimi i Komisionit, që komisionet të kenë buxhet të veçantë në mënyrë që të tejkalohen vështirësitë e përmendura.

Lutfi Haziri - Mendon se, përveç vendeve që u propozuan, Komisioni do duhej të komunikonte edhe me vendet islamike. Sa i përket buxhetit tha se tani është koha të ndërhyhet dhe kërkesa duhet të bëhet në këtë fazë, derisa për buxhetin organizatat janë duke diskutuar me Qeverinë, sepse më vonë është vështirë të lëvizen shifrat për shkak të

skemës buxhetore. Zyrtarët tanë tash duhet ta bëjnë një planifikim në bazë të të cilit do të kërkohet buxhet. Është komision specifik dhe ka punë të ndërlikuara, prandaj sa i përket realizimit të detyrave, duhet të bëhet një plan pune me të cilin arsyetohet ky buxhet. Në fazën tjetër të diskutimit komisioni ynë bëhet funksional edhe në kuptimin e bashkëpunimit me rajonin dhe me BE-në. Në këtë fazë detyrat vijnë duke u shtuar dhe Komisioni ka rol dhe peshë më të madhe, andaj tash duhet të përqendrohemi veçanërisht në bashkëpunimin dhe në funksionalizimin e Komisionit në raport me rajonin. Kjo është shumë e rëndësishme dhe me përparësi.

Ramë Buja - Lidhur me propozimin e parë të kryetarit të Komisionit tha se do duhej të mendohemi edhe pak dhe të vendosim në mbledhjen e ardhshme.

Sa i përket çështjes së raporteve të Komisionit me institucionet, e mbështet këtë, porse ato janë të saktësuara me ligj dhe janë të dukshme aq sa secili në mënyrë institucionale duhet ta dijë se cilat gjëra duhet të ecin në këtë rast.

Lidhur me buxhetin e Kuvendit e mbështet propozimin e parafolësit, sepse mendon se tani është koha dhe është e nevojshme të mendojmë ta realizojmë një projekt dhe të dimë sa duhet të jetë buxheti i Komisionit tonë për t'i përmbushur detyrat.

Ramadan Avdiu - Vlerësoi se sa i përket buxhetit të Kuvendit, si komision ne e kemi edhe një përparësi, sepse shumica e anëtarëve të Komisionit janë anëtarë të Kryesisë dhe së bashku edhe Kryesia dhe Komisioni duhet të bëjnë përpjekje që të zhbllkohet kjo gjendje e qarkullimit të financave. Lidhur me idenë për ndarjen e punëve të anëtarëve të Komisionit nëpër grupe, të mendojmë edhe më gjatë dhe të piquet si ide, të mos shkojmë në mënyrë eksplicite, të bashkëpunojmë vetëm me shtetet e rajonit, me BE-në dhe me SHBA-në. Tani duhet të mendojmë edhe për vende të tjera të botës, sepse gjendemi në fazën e përpjekjeve dhe të insistimeve për njohje kualitative - të mendojmë edhe për shtetet siç janë ato të Afrikës dhe ato të Amerikës Latine. Është e domosdoshme që brenda Komisionit t'i ndajmë disa detyra dhe punë, t'i bëjmë disa qendra konsultative me ekspertë që i njohin ato vende dhe në këtë mënyrë t'i ndihmojmë edhe Ministrisë së Punëve të Jashtme. Për buxhetin konsideron se është çelësi i funksionalizimit dhe i kryerjes së të gjitha këtyre aktiviteteve dhe pajtohet se Komisioni duhet ta ketë buxhetin e vet. Sa u përket organizimit dhe daljes së deputetëve jashtë vendit, do të ishte mirë që Kryesia të vendosë t'ia japë këtë punë këtij komisioni, sepse deri më tani ka qenë shumë e çrregullt mënyra e komunikimit e administratës së Kuvendit në raport me mekanizmat e BE-së.

Kryesuesi – E informoi Komisionin se e kishte bërë një bisedë paraprake, që ende s'e ka formën zyrtare, për krijimin e grupit të miqësisë Kosovë - Francë, për të cilin mendon se është mirë dhe i domosdoshëm. Për këtë ka shenja të interesimit dhe janë bërë biseda elementare paraprake. Më tutje tha se kemi vendosur të formohet grupi i miqësisë parlamentare Turqi - Kosovë, që ka kaluar në Komision dhe në Kryesi, por nuk e di ku ka mbërritur dhe a është kompletuar struktura e tij.

Lutfi Haziri - U ndërlidh në diskutim dhe tha se është kompletuar struktura dhe tani duhet të zgjidhet kryesuesi.

Kryesuesi - Vlerësoi se raporti dhe lidhja me institucionet është problem i koklavitur, jo vetëm i këtij komisioni, por i të gjitha komisioneve të tjera. Ka ndërruar situata dhe tani do të krijojmë raporte institucionale edhe me Ministrinë e Jashtme që është duke u konstituuar dhe i ka bërë disa veprime të brendshme organizative. Në anën tjetër kemi një interpelancë të kërkuar nga një grup parlamentar për ministrin e Jashtëm që do të dalë në Kuvend. Në mënyrë institucionale Komisioni e ka për detyrë ta artikulojë këtë problematikë. Kur thirret për interpelancë një referues duhet të jetë edhe nga Komisioni.

Lutfi Haziri - Propozoj të kërkohet nga Ministria e Jashtme, që Komisioni drejtpërsëdrejti të njoftohet për programin e punës dhe për strukturimin e Ministrisë. Para interpelancës të dihet saktësisht si është formësuar politika e jashtme dhe Komisioni të njoftohet drejtpërsëdrejti për strukturimet dhe ecjet e Ministrisë.

Kryesuesi - Tha se qëllimi i tij është që ministri i Punëve të Jashtme të vijë në Komision dhe të raportojë para interpelancës. Problemi është kontaktimi, sepse ministri ka thënë se është i zënë. Ai patjetër duhet të vijë në Komision dhe t'i shpjegojë politikën dhe kërkesat e shtruara nga parafolësi që lidhen direkt edhe me punën e Komisionit që i ndjek veprimet e politikës së jashtme të Ministrisë së Jashtme dhe të Kuvendit.

Xhavit Haliti – E përforcoi idenë se vërtet ministri duhet të vijë në Komision para interpelancës, në mënyrë që disa çështje jo të rëndësishme të mos diskutohen në Kuvend dhe në opinion. Ministri duhet të vijë vetë në Komision kur ta thërrasim dhe jo ta çojë ndonjë këshilltar ose dikë tjetër. Interes i mbarëvajtjes së punës edhe të Ministrisë është të ballafaqohet me idetë dhe problemet e Komisionit dhe të Kuvendit.

Kryesuesi - Tha se këto ishin probleme që i kishim në rend të ditës për të diskutuar në këtë formë për detyrat që na presin. Në bazë të diskutimeve lidhur me këtë pikë u nxorën këto

Përfundime

1. Komisioni u pajtua që mbledhjet e rregullta t'i mbajë çdo dy javë, të mërkurën, në orën 14: 00.
2. Të kërkohet që në Projektbuxhetin e Kuvendit të krijohet buxhet për Komisionin. Kërkesa të bëhet tash, në mënyrë që vitin e ardhshëm Komisioni të ketë buxhet për ta zhvilluar veprimtarinë e vet.
3. Komisioni t'i rishqyrtojë raportet institucionale në fushën e politikës së jashtme, të shqyrtohen raportet institucionale me kryetarin e Kuvendit, me Kryesinë, me Qeverinë dhe me Ministrinë e Punëve të Jashtme.
4. Ministri i Punëve të Jashtme të vijë në Komision që t'i shpjegojë politikën e jashtme dhe nivelin e organizimit të deritashëm të Ministrisë.
5. Komisioni nuk mori vendim lidhur me çështjen e propozuar si tip i orientimeve të kapacitetit të anëtarëve të Komisionit në bazë të përgatitjes dhe të afiniteteve për angazhimin në komunikim me të tjerët. Çështja mbeti e hapur, për t'u vendosur në mbledhjen tjetër.

3. Të ndryshme

Nuk pati çështje për të diskutuar.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

E përgatiti

Njësia e mbështetjes së Komisionit

Kryetar i Komisionit

Sabri Hamiti